



Nr. 2609 / prot.
1

Datë 18.06 2026

PROCESVERBAL

PËR KONSTATIMIN DHE RISHIKIMIN E LISTËS SË MJEKËVE TË RINJ SPECIALISTË NË SPECIALITETIN OBSTETRIKË-GJINEKOLOGJI

Sot, më datë 18/06/2026, Komisioni “Për organizimin e procesit të përzgjedhjes së vendeve të punës për mjekët me kontratë shërbimi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të cilët kanë përfunduar studimet afatgjata në fushën e mjekësisë në vitin 2026” me marrjen e informacionit të fundit, me email nga Fakulteti i Mjekësisë, konstatoi se mjekja Marinela Lica nuk ka përbushur kushtin për përfundimin e programit të specializimit, pasi nuk ka dhënë provimin përfundimtar.

Në këto kushte, duke qenë se mungesa e këtij kushti përbën fakt të ri që ndikon drejtpërdrejt në procedurën administrative të shpërndarjes, bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Komisioni shqyrtoi nevojën për rishikimin e listës së mjekëve specialistë dhe të nevojave të institucioneve përfituese dhe vendosi:

1. Heqjen e mjekes Marinela Lica nga lista e mjekëve të rinj specialistë që do të përfshihen në procedurën e shpërndarjes për specialitetin Obstetrikë-Gjinekologji.
2. Përditësimin e nevojave të institucioneve shëndetësore për këtë specialitet, duke ndryshuar numrin e vendeve të planifikuara për Spitalin Rajonal Kukës, nga 2 (dy) mjekë specialistë në 1 (një) mjek specialist në specialitetin Obstetrikë-Gjinekologji.
3. Vazhdimin e procedurës së shpërndarjes mbi bazën e listës dhe nevojave të përditësuara sipas këtij procesverbali.

Ky procesverbal u mbajt në dy kopje dhe, pasi u lexua, u miratua dhe nënshkrua nga anëtarët e Komisionit.

KOMISIONI

1. Znj. Eugena Tomini
2. Znj. Blerta Ngucaj
3. Znj. Flutra Beqo
4. Z. Olsi Akshia
5. Z. Denis Heta

Datë: 18/06/2026